



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES**

Nr. 905 prot.

Tiranë, më 03.11.2025

U R D H Ë R

Nr. 103, datë 03.11.2025

Për kryerjen e inspektimit të thelluar, në lidhje me zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil gjatë zhvillimit të procedurës së konkurrimit për plotësimin e pozicioneve vakante të krijuara në periudhën Korrik –Tetor 2025, në institucionin e Bashkisë Vlorë

Në bazë dhe për zbatim të nenit 11, pika 1 dhe nenit 14, të Ligjit Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, si dhe neneve 2, 14 germa a), 16, 19 pika 1 dhe 21 të Rregullores “Mbi Procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, të miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, e ndryshuar, si dhe duke u nisur nga disa informacione të administruara pranë Komisionerit,

URDHËROJ:

1. Nisjen e inspektimit për zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, gjatë zhvillimit të procedurës së konkurrimit për plotësimin e pozicioneve të lira të krijuara në periudhën **Korrik –Tetor 2025**, në institucionin e Bashkisë Vlorë, duke marrë indicie nga disa informacione të ardhura pranë Komisionerit, nga kandidatë pjesëmarrës në këto procese, ku predendohen veprime në kundërshtim me ligjin për nëpunësin civil, si dhe nga një denoncim i medias në një emision investigativ.
2. Inspektimi do të përfshijë sipas objektit, veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet/mekanizmat e tjera të ngarkuara me detyra specifike gjatë procedurave të konkurrimit.
3. Procesi i inspektimit do të kryhet në institucion nga data **10.11.2025**, me paraqitjen e grupit të punës pranë institucionit të Bashkisë Vlorë, ku do të vijohet me procesin e mbledhjes dhe administrimit të të dhënave. Vizita në institucion do të zgjasë deri në datë **14.11.2025**. Materiali final do të jetë gati brenda datës **10.12.2025**.

4. Për çdo parregullsi të konstatuar do të mbahet procesverbal administrativ dhe do të merret kopja e dokumentacionit përkatës, e vërtetuar nga sekretaria e institucionit.
5. Grupi i inspektimit do të ketë përbërjen si më poshtë:

- | | |
|-----------------------|--|
| • Arbana Basha | Drejtor i Përgjithshëm
(Drejtues grupi) |
| • Alda Xhaxhiu | Inspektore
(Anëtar) |
| • Antea Kabali | Inspektore
(Anëtar) |

Pas administrimit të dokumentacionit të nevojshëm, do të përgatitet relacioni, i cili do t'i paraqitet Drejtorit të Përgjithshëm të Mbikëqyrjes dhe Inspektimit për vazhdimin e procedimit, brenda afatit të mësipërm, për ta dërguar për miratim pranë Komisionerit.

6. Në përfundim të procesit, nëse do të konstatohen shkelje të ligjit, do vijojë procedura me përgatitjen e konkluzioneve dhe hartimin e vendimit paralajmërues për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë. Nëse nuk konstatohen shkelje të ligjit, do të përgatitet vendimi përmbyllës i procesit.
7. Inspektimi do të orientohet drejt verifikimit të situatës së administrimit të shërbimit civil, të një kategorie veprimesh administrative në këtë institucion, në lidhje me procedurat e ndjekura në implementimin e institutit të ligjit për shërbimin civil, duke ndjekur këto drejtime:
 - Struktura analitike e institucionit, vendet e lira të krijuara, shkaqet dhe procedura e ndjekur nga njësia përgjegjëse e institucionit;
 - Procedura e ndjekur nga institucioni në lidhje me plotësimi i pozicioneve të lira në shërbimin civil, nëpërmjet konkurrimit dhe si janë respektuar kërkesat e ligjit dhe akteve nënligjore në lidhje me dy fazat e këtij procesi:
 - verifikimi paraprak nga njësia përgjegjëse, nëse konkurrentët i plotësojnë kërkesat e përgjithëshme dhe të veçanta të vendit të punës;
 - vlerësimi i kandidatëve.
 - Emërimi në shërbimin civil pas përfundimit të procesit të konkurrimit dhe menaxhimi i listës së kandidatëve fitues që kanë arritur pikët, por që nuk janë emëruar.
 - Verifikimi i procedurës së ndjekur, në rastin e shqyrtimit të ankesave për secilën procedurë konkurrimi.

8. Për të përfunduar këtë proces, grupit të inspektimit duhet t'i vihen në dispozicion aktet administrative si më poshtë:
- a) Struktura organizative dhe analitike e Bashkisë Vlorë, e cila është në fuqi për vitin 2025.
 - b) Listëprezenca dhe listëpagesa e punonjësve të institucionit për muajin Tetor 2025.
 - c) Formulari i përshkrimit të punës për të gjitha pozicionet të përfshira në procesin e konkurrimit.
 - d) Urdhrat për ngritjen e KPP, KB, KPND, për procedurat e zhvilluara.
 - e) Dosjet me dokumentacionin e dorëzuar nga kandidatët pjesëmarrës në procedurën e konkurrimit për plotësimin e pozicioneve të lira, pranë Bashkisë Vlorë.
 - f) Dokumentacioni i plotë i administruar në dosjen e konkurrimit, në të cilin materializohet procedura e ndjekur për plotësimin e këtyre pozicioneve të lira pranë institucionit të Bashkisë Vlorë; duke filluar me aktet që materializojnë publikimin e vendit vakant si dhe procedurën e konkurrimit të ndjekur në të gjitha fazat e saj;
 - g) Materiale të tjera të cilat do të konsiderohen të domosdoshme për verifikimin e situatës së shërbimit civil në këtë institucion dhe do të kërkohen gjatë procesit të mbikëqyrjes.
9. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe grupi i inspektimit, që të marrë masat për realizimin e procesit, duke filluar me njoftimin e subjektit që do t'i nënshtrohet inspektimit, që është Bashkia Vlorë, në përputhje me nenin 42, të Kodit të Procedurave Administrative dhe të akteve që janë pjesë e këtij vendimi.
10. Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse të marrë masat e nevojshme që të sigurojë mbështetjen e grupit të punës me logjistikë, për vijimin normal të procesit.
11. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha

